REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 356, 373, 389/23
Datë/Datum. 01.08.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 356/23
373/23
389/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërjen Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga "NPN Euroing SH.P.K.", me numër protokolli 2023/0356, ankesa e OE "Astraplan SH.P.K", me nr. protokolli 2023/0373, ankesa e OE "Pro & Co Group sh.p.k.,me nr. protokolli 2023/0389, për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Stacionit Policor Veri Prishtinë" me nr. të prokurimit: 214-22-10936-5-1-1, iniciuar nga Policia e Kosovës me 01.08.2023, mori:

VENDIM

1. Refuzohet ankesa e operatorit ekonomik OE "NPN Euroing SH.P.K.", e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 06/06/2023, numër protokolli 2023/0356, për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Stacionit Policor Veri Prishtinë" me nr. të prokurimit: 214-22-10936-5-1-1, iniciuar nga Policia e Kosovës.

2. Aprovohen, si të bazuara ankesat e OE "Astraplan SH.P.K", me nr. 2023/0373, e datës 09/06/2023 dhe ankesa "Pro & Co Group sh.p.k.,me nr. 2023/0389, e datës 12/06/2023, kurse vendimi i AK Policia e Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Stacionit Policor Veri Prishtinë" me numër të prokurimit 214-22-10936-5-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara me rastin e parashtrimit të ankesës, me ç'rast Ankuesit duhet të paraqaqes kërkesë për kthimin e mjeteve brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e

pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP;

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 14.10.2022, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Stacionit Policor Veri Prishtinë" me nr. të prokurimit: 214-22-10936-5-1-1.

AK me datën 24.05.2023, ka publikuar njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit.

OE pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit OE "NPN Euroing SH.P.K.", OE "Astraplan SH.P.K", dhe OE "Pro & Co Group sh.p.k kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 01.06.2023, AK me vendim ka refuzuar kërkesat për rishqyrtim të OE ankues.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "NPN Euroing SH.P.K.", me numër protokolli 2023/0356, ankesa e OE "Astraplan SH.P.K", me nr. protokolli 2023/0373, ankesa e OE "Pro & Co Group sh.p.k, kanë parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për anulim të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 1 538 842,70€.

Ankesat e OE janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE kanë ushtruar po ashtu kërkesat për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesat i plotësojnë kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Shqyrtimi paraprak i ankesës

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar eksperten vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik OE "NPN Euroing SH.P.K.", me 21.06.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE te refuzohet si e pabazuar respektivisht OE te trajtohet palë pa interes ne kuptim te nenit 4.1.26 pasi qe për shkak te mos plotësimit te aspektit administrativ nga ana e OE ankues.

Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik OE "Astraplan SH.P.K.", me 22.06.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik OE "Pro & Co Group sh.p.k", me 22.06.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Konstatimet dhe mendimi i ekspertit shqyrtues

Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik OE "NPN Euroing SH.P.K."

Eksperti konstaton se AK gjate vlerësimit dhe rivlerësimit te ofertave nuk ka respektuar afatet kohore për vlerësim dhe rivlerësim për faktin se me date 29.11.2023 është ber hapja publike e ofertave, ndërsa me date 16.02.2023 AK ka dal me rezultat respektivisht me vendim për dhënie te kontratës, por pas parashtrimit të kërkesave për rishqyrtim te vendimit, AK me date 06.03.2023. nxjerr vendim dhe aktivitetin prokurimit e kthen ne rivlerësim, pasi qe kërkesat për rishqyrtim aprovohen pjesërisht të bazuara.

Nga data 06.03.2023 kur është marre vendim për rivlerësim deri me date 24.05.2023 Autoriteti Kontraktues nuk ka ndërmarr asnjë veprim dhe kjo bie ndesh edhe me rregullat e prokurimit publik pasi qe afati ligjor për vlerësim te aktivitet te prokurimit është 30 dite me mundësi shtyrje për 20 dite tjera ne rast se konsiderohet se aktiviteti është kompleks për ta vlerësuar apo rivlerësuar.

Sipas vendimi te datës 24.05.2023 Autoriteti Kontraktues OE ankues e ka eliminuar me arsyetimin si ne vijim "listën e përshkrimit te çmimeve nuk e ka plotësuar sipas kërkesës se AK përkatësisht ka ofruar çmimin e njëjtë sikur totali i përgjithshëm PA TVSH dhe totalin me TVSH dhe tek TVSH nuk ka vendos çmime po tekst e qe bie ndesh me nenin 44.3 te rregullores për prokurim publik 01/2023" dhe njëkohësisht si prove apo si argument ka marre edhe një interpretim te KRPP-se sipas se cilit nuk lejohet qe te korrigjohet apo te behet asnjë lloj ndërhyrje tek përshkrimi i çmimeve si pjese përbërës e formularit te tenderit .

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne rregullat e përgjithshme si dhe ne interpretim qe ka dhënë KRPP lidhur me ketë rast vlerëson se AK me rastin e refuzimi te kërkesës për rishqyrtim te

parashtruar nga OE ankues ka vepruar drejte për faktin se formulari i përshkrimit te çmimeve ka qene shume i qarte pasi qe sipas formularit (paramases dhe parallogarise) çmimet për njësi janë kërkuar qe te ofrohen pa TVSH dhe totalit te çmimeve pa TVSH ti shtohet norma e TVSH-se tek rekapitullimi i paramases.

Konkretisht paramasa ka qene si ne vijim:

Çdo ofertues me rastin e ofrimi te çmimeve për njësi është i obliguar qe ti përmbahet formularit te përshkrim te çmimeve ne te kundërtën konsiderohet oferte e papërgjegjshme pasi qe mos plotësimi i ofertës sipas kërkesave te AK nënkupton eliminim nga procesi i vlerësimit pasi qe është kusht administrativ.

Eksperti vlerëson se AK nuk ka vepruar ne kundërshtim me shkeljet pretenduara ne ankese pasi qe trajtimi i ofertës se OE ankues është refuzuar ne përputhje me dispozitat e LPP-se dhe rregullat për prokurim publik sepse çmimi nuk mund te jete i njëjtë sikurse çmimi me TVSH dhe çmimi pa TVSH ne rastet kur aplikohet norma e TVSH-se dhe tek paramasa dhe tek parallogaria nuk është lenë mundësia qe te vendoset tekst por te vendoset vlere financiare prej 18 % mbi çmimet pa TVSH dhe kjo ka qene obligative qe te respektohet nga secili ofertues ne mënyrë qe oferta te jete administrativisht te jete e përgjegjshme.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK nuk ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se pasi qe oferta e OE ankues nuk mund te trajtohet si oferte e përgjegjshme për arsyet e cekura me larte.

Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik OE "Astraplan SH.P.K."

Autoriteti Kontraktues-Policia e Kosovës përmes B58-Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 23.05.2023, Anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se nuk kemi asnjë ofertë të përgjegjshme.

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit të operatorit ekonomik ankues, Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 26.04.2023 ku AK-Policia e Kosovës, ka potencuar: Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm; OE është i papërgjegjshëm pasi nuk ka plotësuar pikat në vijim:

"Ne dosjen e tenderit është kërkuara Një autovinç (kamion për bartjen te materialeve ndërtimore min.7 ton OE nuk e ka pas ka ofertuar një kamion vinç prej 5 tone dhe një koke tërheqëse e cila nuk e plotëson kushtin e AK kamion transportues."

OE ankues paraqet kërkesë për rishqyrtim me datë 26.05.2023, ndërsa AK me datë 01.06.23 nëpërmjet vendimit refuzon kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar dhe në këtë vendim, faqe 3, të përgjigjet e AK-së për OE "Astraplan" Sh.p.k. jepen sqarime, ku AK cek se

"...kërkesa në dosje të tenderit ka qenë si në vijim *Një autovinç (kamion për bartje të materialeve ndërtimore min. 7ton, ju në ofertën tuaj keni kamion kran me 2 dyer me numër të targës 03-827-DI ku pesha maksimale e ngarkesës është 5.2 ton ju keni ofruar kokën tërheqëse me kran me dy dyer me tabelë 03-524-DE ku kjo nuk e plotëson kërkesën e AK-së pasi është kërkuar kamion vinç dhe jo kokë tërheqëse siç e keni ofruar ju. Pra asnjëra nga makineritë e ofruara nuk e përmbush kërkesën e AK në lidhje me autovinç e kërkuar nga ana e AK dhe pretendimi i juaj ankimor është i pabazuar."

Operatori ekonomik ankues pretendon se posedon këtë makineri dhe ka bashkangjitur dëshminë në platformën elektronike të e-prokurimit; (dokumentin me nr.6.4 Lista e pajisjeve Universal dhe Unicron SHPK pjesa 3) faqe 5; Foto kamioni me rimorkio Koka tërheqëses me targa 03-524-DE dhe rimorkio me targa 03-436-XB.

Faqe 6: Libreza (CRA) me nr.1923154,targat 03-524-DE, Koke tërheqëse me kran (F1-pesha bartëse 7200 kg ose (7.2 ton).

Faqe 7: Libreza (CRA) me nr.1542907, targa 03-436-XB,Rimorko, F1-pesha bartës 24900 kg,(24.9 ton)

Operatori ekonomik ankues potencon se "Rimorkio me koke tërheqëse është kamion i kompletuar dhe ka kapacitetin 7.2 ton vinçi dhe 24.9 ton mund te barte transport te materialeve se bashku kanë 32.1 ton."

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK tek kërkesat e FDT Kapaciteti teknik dhe profesional: 9.1 & 9.2 ka kërkuar:

Kerkes 5-OE duhet ta ofrojë listën mbi mjetet e punës e nënshkruar dhe vlerësuar nga OE me pajisjet ne vijim Pesë (5) kamion veteshkarkues minimum 10m3-15m3, • Dy (2) eskavator me minimum 8ton, • Një(1) cilinder min 10ton, vibrues • Një autovinç (kamion per bartje te materialeve ndertimore min 7ton) • Një (1) vinç statik qe vendoset ne vende punishte me lartësi deri ne 30m, •Pajisje skele, dërrasa min 1000m2 (sipas ndhëzimit te fundit kërkohet qe te përcillet objekti me skele gjate ndërtimit për shkak te sigurisë ne punë i gjithë perimetri i objektit). • Një (1) gjenerator me kapacitet min. 20-35 KWA.	**Deshmi 5- OE duhet te ofrojë listën e pajisjeve te kërkuara për ekzekutimit të punëve e vulosur dhe nënshkruar, për automjetet që kanë regjistrim të dëshmohet me librez valide dhe foto, ndërsa për pajisjet tjera te dëshmohet me foto dhe deklaratë mbi posedimin e tyre apo marrëveshje mbi marrjen me qera për projektin në fjalë**

Ekspertja shqyrtuese sqaron OE ankues me tender ka bashkangjitur dokumentin me titull "6.4 LISTA E PAISJEVE UNIVERSAL DHE UNICRON SHPK PJESA 3.pdf", faqe 5 gjenden fotot e kamionit me targa 03-524-DE, si dhe fotot e rimorkios me targa 03-436-XB. Në dokumentin e njëjtë, faqe 6 gjendet libreza (CRA) me nr.1923154 për mjetin me targa 03-524-DE, ku në këtë librezë ceket se pesha maksimale e ngarkesës së lejuar është 7200 kg (7.2 ton). Po ashtu, në faqe 7 të këtij dokumenti gjendet edhe libreza e rimorkios Libreza (CRA) me nr.1542907, targa 03-436-XB, Rimorkio, me peshë maksimale të ngarkesës së lejuar 24900 kg (24.9 ton).

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit të kërkesës së AK dhe dokumenteve të bashkangjitura nga OE ankues, më saktë certifikatës së regjistrimit të automjetit, sqaron se pajisja/mjeti me targa 03-524-DE koke tërheqëse me kran ka peshën bartëse tonazhën 7200kg (7.2 ton).





Ndërsa rimorkio (bartësja) me targa 03-436-XB sipas certifikatës së regjistrimit ka peshën bartëse 24900 kg (24.9 ton), shih dëshminë me poshtë:


RKS
1542907
1542907





Mbetet në përgjegjësi të autoritetit kontraktues që gjatë rivlerësimit ta sqarojë kërkesën nr.5 tek Kapaciteti teknik dhe profesional: 9.1 & 9.2 Një autovinç (kamion për bartjen te materialeve ndërtimore min.7 ton.

Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës ne platformën e-prokurimit ka has në kërkesën për informacione shtesë të datës: 27.10.22, nga një operator ekonomik lidhur me kërkesën e Kapaciteti teknik dhe profesional: Një autovinç (kamion për bartjen te materialeve ndërtimore min.7 ton.

Ne këtë kërkese është kërkuar sqarim si në vijim:

Pyetja 2 është:

Te Kërkesa 5 – Një Autovinç (kamion për barrën e materialeve ndërtimore min. 7 ton)

A kërkohet Autovinç i cili duhet të mundet (1) bart min. 7 ton materiale ndërtimore vinçi apo keni kërkuar Kamion me Kran (1 vinç) ku perpos kranit kamioni mundet të ngarkohet me material ndërtimor min. 7 ton si dhunë, shasiori etj.

Ilustrim:

Figura A



Figura B



Për cilen e keni fjalën? Figura A Kamion me vinç apo Figura B Autovinç

Por lidhur me ketë sqarim të kërkuar nga operatori ekonomik, ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës nuk ka has në përgjigjen e autoritetit kontraktues.

Lidhur me pretendimi e OE ankues kundrejt ofertës së operatorit ekonomik NPN Euroing shpk se nuk ka dorëzuar specifikat teknike të vulosura dhe të nënshkruara në deklaratën nuk përmendet aneksin 1. Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës sqaron se nuk qëndron pretendimi i

OE ankues për faktin se me tender OE NPN Euroing shpk ka bashkangjitur dokumentin me titull 3. Kërkesa për sekret Afarist, deklarata specifikime.pdf

Lidhur me pretendim ankimore se operatorit ekonomik NPN Euroing shpk se nuk e ka plotësuar paramasen sipas kërkesës se DT dhe korrigjimi i çmimit i bie me shumë se 2%, po ashtu edhe konform nenit 44.3 të Rruopp-s dhe interpretimit të KRPP-s, është ndërhyrje ne paramas. Për ketë pretendim ankimor ekspertja shqyrtuese sqaron se ka raport të ekspertizës me nr.356-2023.

Lidhur me pretendim ankimore se operatorit ekonomik NPN Euroing shpk nuk i plotëson kriteret përkatësisht Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale ka paraqit vetëm një inxhinier ndërtimi të drejtimit konstruktiv qe e ka emëruar udhëheqës të punishtes qe mbulon kërkesën 4, ndërsa piken e pare te kërkesës nr.2 nuk ka asnjë person qe e mbulon ketë kërkese. OE tutje thekson se menaxher i projektit mundë të shfrytëzohet njeri nga stafi, por jo edhe udhëheqësi i punimeve me ketë rast OE nuk ka plotësuar kërkesën nr.2 te nenit 9.1&9.2 të DT-s. Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues për faktin se me tender OE NPN Euroing shpk ka bashkangjitur dokumentin me titull: "8. 9.1&9.2. Lista e Stafit profesional dhe vendimi për Menaxher udhëheq punishte.pdf" ndërsa sa i përket pikës tjetër ankimore edhe menaxheri i projekteve dhe udhëheqësi i punimeve kanë mundur të caktohen nga lista e stafit profesional të prezantuar nga operatoret ekonomik pjesëmarrës, nuk ka pas kufizime apo kërkesë tjetër për këto dy pozita ashtu siç pretendon OE ankues andaj pretendim i OE ankues nuk qëndron.

Operatori ekonomik ankues referohet në ankesë operatorit ekonomik NPN Euroing shpk si i rekomanduar për kontratë, ekspertja shqyrtuese sqaron se në vlerësimin fillestar nga AK është rekomanduar për kontratë NPN Euroing shpk por pas kërkese për rishqyrtim AK anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se nuk ka pas asnjë ofertues të përgjegjshëm sipas kërkesave të AK-së, andaj nuk ka operator ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës siç pretendon OE ankues.

Lidhur me pretendim e OE ankues se AK ka bere shkelje të afateve kohore pasi që vlerësimi fillestar ka zgjatur nga hapja me 29.11.2022 deri me 16.02.2023 vendimi i parë (79 ditë) e ri vlerësimi nga data 27.02.2023 deri me 23.05.2023 (85 ditë), Ekspertja shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues lidhur me tej zgjatjen e afateve të vlerësimit të ofertave është i bazuar për faktin se edhe në raste kur natyra e aktivitetit të prokurimit është shumë komplekse, AK duhet që brenda 50 dite (1 muaj e 20 ditë) të përfundoj ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas nenit 40.3 të RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK. Pra kjo dispozitë ligjore e ka kufizuar vlerësimin e ofertave dhe nuk mund të zgjatet më shumë afati për vlerësim se 1 muaj e 20 ditë. Në rastin konkret, AK ka bërë hapjen e ofertave me datë 29.11.2022, ndërsa njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues është bërë me datë 16.02.23, që i bie afër tre muaj. Po ashtu edhe në herën e dytë të vlerësimit, AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 40.3 të RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, ku vlerësimin e kishte kryer pas më shumë se 2 muaj.

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit të operatorit ekonomik ankues Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 26.04.2023 ku AK -POLICIA E KOSOVËS, ka potencuar: Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm; OE është i papërgjegjshëm pasi nuk ka plotësuar pikat në vijim:

Kërkesa 3-Operatori Ekonomik duhet të caktoj një menaxher të projektit me profesion inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – konstruktiv ose inxhinierë i arkitekturës (apo master jo bachelor), i cili duhet të këtë përvojë pune minimumi 5 vite pas diplomimit.

Kompania nuk ka ofruar kontratë apo para kontratë për ing.Shaqir Idrizin sipas dëshmive të kërkuara nga ana e AK.

Kërkesa 4-Operatori Ekonomik duhet të caktoj një udhëheqës te punimeve me profesion inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv (apo master jo bachelor), i cili duhet të këtë përvojë pune minimumi 5 vite pas diplomimit.

Ing.i prezantuar nga kompania Sadet Ahmeti nuk ka përvojë pune 5 vite pas diplomimit dhe duke ju referuar rregullores 001/2023 për prokurim publik nenin 10.1 ku thotë:

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

OE ankues paraqet kërkesë për rishqyrtim me datë 29.05.2023. AK me datë 01.06.23, nëpërmjet vendimit refuzon kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues, pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 10, 59, 60, 62, 65, 71, 72 dhe 108/A të LPP-së, dhe dispozitat e Rruopp-së dhe kërkesat e dosjes se tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK e ka eliminuar pa të drejte me arsyetimin se kompania nuk ka ofruar kontratë apo para kontratë për ing.Shaqir Idrizin sipas dëshmive të kërkuara nga ana e AK, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se AK tek kërkesat Kapaciteti teknik dhe profesional pika 9.1 & 9.2 ka kërkuar:

Kerkesa 3-Operatori Ekonomik duhet të caktoj një menaxher të projektit me profesion inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – konstruktiv ose inxhinierë i arkitekturës (apo master jo bachelor), i cili duhet të këtë përvojë pune minimumi 5 vite pas diplomimit	**Deshmi 3-Vendim me shkrim për caktimin e menaxherit te projektit (mundet te jete njeri nga stafi profesional i prezantuar) - i nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, diploma e noterizuar, CV dhe referencat mbi përvojën e punës (në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës)**

OE ankues me tender ka dorëzuar listën me stafin profesional, ku në këtë liste është përshkruar eksperienca dhe pozita në kompani e stafit, Ing. Shaqir Idrizi, sipas kësaj liste ka 15 vite përvojë pune. Me ofertë për ketë inxhinier është bashkëngjit vendimi mbi emërimin si menaxher i projektit, diploma, cv dhe referencat, por nuk ishte bashkangjitur edhe **"kontrata ose para kontrata e punese valide me punëdhënësin"** siç ka qenë kërkesa e AK-së. Mirëpo, OE ankues me rastin e parashtrimit të kërkesës për ri shqyrtim të datës 29.05.2023, kishte prezantuar listën e deklarimeve të pagave për punëtoret në ATK për vitin 2022 dhe tremujorin e parë të vitit 2023 dhe në mesin e tyre ishte i deklaruar edhe ing. Shaqir Idrizi, kishte bashkangjitur Kontratën e punës për kohë të caktuar në mes punëdhënësit PRO&Co Group sh.p.k dhe të punësuarit Shaqir Idrizi, ne nenin 4 po të kësaj kontrate ceket se i punësuari themelon marrëdhënie pune në kohen e caktuar duke filluar nga 4 Maj 2022 deri me 04 Maj 2023, kjo kontratë është nënshkruar mes palëve dhe e noterizuar pranë noterit më numër rendor 3860/2022, noterizuar me datë 09.06.2022. Po ashtu ishte bashkangjitur edhe kontrata e noterizuar pranë noterit me numër rendor 1485/2023 me datë 08.03.2023, ku përmes kësaj kontrate i vazhdohet marrëdhënia e punës deri me datë 31.12.2023. Andaj, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se duke pasur parasysh që hapja e ofertave ishte bërë me datë 29.11.2022, ndërsa kontrata e noterizuar tek noteri është bërë me datë 09.06.2022 (para publikimit të njoftimit për kontratë dhe para hapjes së ofertave) për ing. Shaqir Idrizi, si dhe vërtetohet se ky inxhinier është deklaruar në listën e pagave në ATK, **ekspertja shqyrtuese** konsideron se AK është dashur që ti pranoj këto dokumente për arsye se lista e pagave të punëtorëve e dëshmuar me vulë të ATK-së vërteton se ky inxhinier kishte qenë i punësuar dhe deklaruar në ATK-së si punëtor i këtij biznesi. Nëse analizohet kjo listë e pagave, shihet që deklarimi i këtij inxhinieri është konform kontratës së vitit 2022, ku sipas kësaj kontrate Shaqir Idrizi ishte punësuar në muajin maj 2022 dhe deklarimi i këtij punëtori në ATK ishte bërë po në muajin maj 2022. Andaj, pretendimi i OE ankues është i **bazuar.**

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK e ka eliminuar pa të drejte me arsyetimin se ing. Sadet Ahmeti nuk përmbush periudhën e përvojës se punës prej 5 vite pas diplomimit, tutje OE potencon se AK ju referuar datës se marrjes se diplomës e jo edhe datës se diplomimit.
Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK tek kërkesat Kapaciteti teknik dhe profesional pika 9.1 & 9.2 ka kërkuar:

Kerkesa 4-Operatori Ekonomik duhet të caktoj një udhëheqës te punimeve me profesion inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv (apo master jo bachelor), i cili duhet të këtë përvojë pune minimumi 5 vite pas diplomimit	**Deshmi 4-Vendim me shkrim për caktimin e udhëheqësit te punimeve - i nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, diploma e noterizuar , CV dhe referencat mbi përvojën e punës (në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës)**

OE ankues përmes ofertës ka dorëzuar listën me stafin profesional, ku në këtë listë është përshkruar eksperienca dhe pozitat e stafit në kompani, Ing. Sadat Ahmeti sipas kësaj liste ka 5 vite provoj pune. Gjithashtu për Ing. Sadat Ahmeti, është bashkangjitur diploma, kontrata, vendimi i MASHT- për njohje të diplomave dhe kualifikimeve të arsimit të lartë të fituara jashtë Republikës së Kosovës, CV, referencat dhe vendimi për caktimin e udhëheqësit të punimeve. Sipas diplomës së prezantuar, z.Sadat Ahmeti me datën 14 shtator 2017 ka diplomuar, kurse data e lëshimit të diplomës mban datën 14 korrik 2018. Andaj, **ekspertja sqaron** se data e lëshimit të diplomës nuk

lidhet me datën e diplomimit sepse në pjesën poshtë emrit dhe mbiemrit të diplomuarit ceket se "me 14 shtator 2017 i ka përmbushur të gjitha kërkesat për lëshimin e kësaj diplomë..."Andaj pretendim i OE ankues në këtë pikë është **i bazuar**.

Sa i përket konstatimit të AK në lidhje me përvojën e punës, ku ka cekur se ky inxhinier nuk i posedon 5 vite përvojë pas datës së diplomimit dhe referencat e dorëzuara me kërkesën për ri shqyrtim dallojnë nga referencat fillestare të dorëzuara me tender, **ekspertja shqyrtuese sqaron** se në CV e këtij inxhinieri te dorëzuar me tender ceket se ka përvojë pune tek:

1. DEKOR Group SHPK Prishtinë 2010 – 2016;
2. Globus Construction-S Gjilan 2018 – 2020;
3. DUA ARCH SHPK 2020;
4. LUNARI Compani 2019 – 2020 – 2021;
5. EURO TRANS 2018 - 2019;
6. Pro & Co Group SH.P.K. 2017 – 2021
7. Studio e Projektimit Urbanistik "Vizion Project" 03.01.2014 – 31.12.2017;

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se kërkesë e AK-së ka qenë që për përvojën e punës të dëshmohet me referenca mbi përvojën e punës (***në referenca duhet të jenë të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës)***. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë të DT-së dhe CV së bashkangjitur për këtë inxhinier dhe referencave të bashkangjitura, **ekspertja shqyrtuese** sqaron si më poshtë:

1. Punëdhënësi "DEKOR Group" është para datës së diplomimit dhe kjo përvojë e punës nuk është sipas kërkesës së AK-së;
2. Për përvojën tek GLOBUS Construction SHPK është pas datës së diplomimit por nuk është bashkangjitur referencë;
3. Për përvojën e lëshuar nga "DUA ARCH" SHPK është lëshuar referenca për periudhën 05.05.2020 deri me 31.05.2021, ku nga kjo referencë rezulton se tek ky punëdhënës ka përvojë 13 muaj;
4. Për punëdhënësin LUNARI Compani nuk është bashkangjitur referencë;
5. Lëshuesi i referencës "PRO & CO" ceke se Sedat Ahmeti është i angazhuar në kompaninë e tyre si inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë por në këtë letër referencë nuk saktësohet periudha apo vitet e punës ashtu siç është kërkesa e DT-së por vetëm projektet e realizuara që Ing. Sadat Ahmeti ka udhëheq punimet në këto projekte.

Po ashtu **ekspertja shqyrtuese** ka analizuar edhe referencat e dorëzuara më kërkese për rishqyrtim nga OE ankues, ku pas shqyrtimit të këtyre referencave rezulton se referenca e lëshuar nga "DUA ARCH" dallon nga referenca fillestare e dorëzuar me tender (për nga numri i projekteve). Pastaj sa i përket përvojës tek "LUNARI", me tenderin e dorëzuar mungonte referenca ndërsa në CV ceket periudha për vitet 2019, 2020 dhe 2021, ndërsa me kërkesën për rishqyrtim ishte bashkangjitur referenca e lëshuar nga LUNARI për vitet 2019, 2020 dhe 2021. Po ashtu me kërkesën për rishqyrtim është bashkangjitur edhe referenca e lëshuar nga Vizion Project për periudhën "nga 01.01.2018 gjer më tani". Ndërsa për referencën e lëshuar nga Pro & Co Group dhe të dorëzuar me kërkesën për shqyrtim, tani në këtë referencë ceket se Sedat Ahmeti ka bërë mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e projekteve nga janari 2017 deri në nëntor 2022.

Lidhur me këtë referencë të dorëzuara me kërkesën për rishqyrtim, **ekspertja** vlerëson se konstatimi i AK-së është i saktë pasi referenca e dorëzuara herën e dytë dallon nga ajo e dorëzuara me tender. Pasi letër referencën e lëshuar nga Pro & Co Group në herën e parë nuk ceket periudha

e punës siç ka qenë kërkesa e dosjes së tenderit që të jenë të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës, kurse herën e dytë është saktësuar periudha e punës (janari 2017 deri në nëntor 2022). Ndërsa tek kompania Globus Construction-S Gjilan edhe pse ceket në CV se Ing. Sadat Ahmeti ka përvojë pune por nuk ka bashkangjitur referencë siç ka kërkuar AK.
Meqenëse në CV dhe me disa referenca është prezantuar informacioni lidhur me përvojën e punës, të z.Sadat Ahmeti dhe ligji i prokurimit lejon sqarime edhe plotësimin e dokumenteve që mungojnë andaj autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit konform nenit 72 të LPP-së do duhet të kërkonte sqarime shtesë lidhur me përvojën punës të inxhinierit Ing. Sadat Ahmeti.
Lidhur me pretendimi e OE ankues kundrejt ofertës së operatorit ekonomik NPN Euroing shpk se ka ndërhy në formularin e përshkrimit të çmimit ku ka modifikuar paramasen. Tutje OE potencon se për këtë çështje ka kërkuar nga KRPP interpretim ligjor dhe KRPP përmes përgjigjes dhe interpretimit të dt. 02.03.2023 konstatohet pa përgjegjshmëria e te njëjti OE. Për këtë pretendim ankimor ekspertja shqyrtuese sqaron se ka raport të ekspertizës me nr.356-2023.

Lidhur me pretendimi e OE ankues kundrejt ofertës së operatorit ekonomik Astraplan i njëjti ka prezantuar ofertë te pa përgjegjshme dhe të konstatuar nga vet AK –Policia e Kosovës. Për këtë pretendim ankimor ekspertja shqyrtuese sqaron se ka raport të ekspertizës me nr. 373/23.

<u>Provë: Diploma e Sadat Ahmeti , Lista e pagave të deklaruar në Atk për vitin 2022 dhe 2023, Kontrata e punës e Shaqir Idrizit dhe Akti noterial me nr.3860/2022 i dt; 09.06.2022</u>


FACULTY OF MANAGEMENT

DIPLOMA

of the acquired scientific title

Sedat (Ukshin) Ahmeti

MAGISTER
OF CONSTRUCTION INDUSTRY

Pro & Co GROUP

[illegible]

Me bazë të nenit 10 paragrafi 2, pika (2.1 dhe 2.2, dhe neni 11 të Ligjit të punës Nr. 04/L-[illegible] i miratuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më di. 01.12.2014), Punëdhënësi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

KONTRATË PUNE PËR KOHË TË CAKTUAR

Neni 1

Me këtë Kontratë: **PRO & Co Group sh.p.k** me numër unik identifikues **811092254**, me seli në: Nr. Marigona Residence, Llapllasellë,Graçanicë, drejtori Kenan Emini (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë kontratë pune me: **Shaqir Idrizi** me numër personal: **[redacted]** (në tekstin e mëtejshëm: I punësuari).

Neni 2

I punësuari do të kryej këto detyra të punës: **Inxhinier i Ndërtimarisë – Konstruktiv**

Neni 3

I punësuari do të kryejë punën në: **Pro & Co Group sh.p.k**

Neni 4

I punësuari themelon marrëdhënie pune, në: kohë të caktuar, duke filluar nga: **04 Maj 2022** deri me **04 Maj 2023**.

Neni 5

Neni 24

Pas njoftimit me përmbajtjen e Kontratës, këto Kontratë nga palët kontraktuese u nënshkruan me datën: **04 Maj 2022**, në: **Graçanicë**, në: **2 kopje autentike nga 3 faqe**, nga të cilat, secilës palë i mbetet nga 1 kopje.

Punëdhënësi:
PCG
Pro & Co Group sh.p.k

I Punësuari:
Shaqir Idrizi

REPUBLIKA E KOSOVËS
NOTER:
NASER S. PAJAZITI
VITI

Numri rendor: 3860/2022

Unë,NOTER –Naser Pajaziti ,me zyrë noteriale në Viti,Rr."Xhemail Ademi" nr.54,----------
Vërtetoj se "Pro & Co Group Sh.P.K., me seli në Llapllasellë rruga "Marigona
Residence" p.n. , identifikuar sipas Certifikatës së biznesit me nr. unik identifikues
811092254, i përfaqësuar nga Drejtori Z. Kenan Emini, i lindur në Viti,Komuna e
Vitisë,me [redacted], me vendbanim të përhershëm në Zhiti,Komuna e
Vitisë,identiteti i të cilit konstatohet nga Letërnjoftimi me nr. personal [redacted]
të lëshuar nga RKS-MPB me datë 12.01.2016 dhe,
Z.Z.Shaqir Idrizi, i lindur më 08.02.1974 në Buzovik,Komuna e Vitisë,shtetas i
Republikës së Kosovës,identiteti i të cilit konstatohet nga letërnjoftimi me numër
personal [redacted], me vendbanim në Viti rruga "Daut Zeneli" p.n.
nën pranimë time kanë nënshkruar me dorë të vetë këtë "Kontratë Pune Për Kohë Të
Caktuar" dhe është vërtetuar me vulën e firmës " Pro & Co Group Sh.P.K., dhe
Sh.Idrizi.
identitetin e të lartëpërmendurve e kam vërtetuar në bazë të letërnjoftimeve me nr.
[redacted], dhe [redacted] të lëshuar nga MPB të Kosovës ,që më janë prezentuar.
Nënshkrimi i të lartëpërmendurve në dokumentin e sipër dhe vula janë vënë në çdo faqe
në prani të Noterit dhe janë autentik.
Shpenzimet janë paguar nga pala me vlerë prej 9,80 euro+ 18%Tush bazuar në tarifën nr 02,
bazë për pagesën shërbimit të noterëve.
Bazuar në Ligjin mbi Noterinë ,Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen dhe nuk obligohet nëse
gala ka apo jo të drejtë në lidhjen e kësaj pune [illegible] dokument.
Në Viti,me Nënë Qershor Dymbë e Njëzetë [illegible]

Noteri
Naser Pajaziti

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financës, Punës dhe Transferiveve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo

LISTA E PAGAVE PËR KOMPANINË

ATK-KSsdurig 2/2/2023 2:55:36 PM

NR FISKAL	811092254
EMRI I KOMPANISË	Pro & Co Group SH.P.K.
ADRESA	P.P.
LLOJI I BIZNESIT	SH.P.K.
GENERA TATIMORE	OTM
VITI	2022

NR	EMRI	MBIEMRI	NR PERSONAL	PRIM	MUAJT 1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
50	SHAQIR	IBREZI	[redacted]	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financës, Punës dhe Transferiveve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo

LISTA E PAGAVE PËR KOMPANINË

ATK-KSbszaini 4/20/2023 1:37:14 PM

NR FISKAL	811092254
EMRI I KOMPANISË	Pro & Co Group SH.P.K.
ADRESA	P.P.
LLOJI I BIZNESIT	SH.P.K.
GENERA TATIMORE	OTM
VITI	2023

54	SHAQIR	IBREZI	[redacted]	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+

Prandaj ne mbështetje te asaj qe u përshkrua si më lartë, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në Ri Vlerësim.

Konstatimet e Panelit Shqyrtues

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në ketë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet OE dhe AK si dhe raportet e ekspertëve shqyrtues.

Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik OE "NPN Euroing SH.P.K."

Duke ju referuar veprimeve të ndërmarra si më sipër, Paneli Shqyrtues konsideron se janë plotësuar kushtet për të vendosur në mënyrë meritore mbi këtë çështje, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, duke pasur parasysh faktin se aktet dhe veprimet dhe parashtresat e palëve, provat në dispozicion dhe raporti i ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me çështjen.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se AK nuk ka shkelur dispozitat e cituara si më sipër, të precizuara dhe të argumentuara ato në ankesë dhe në raportin e ekspertit shqyrtues. Në ketë rast Paneli shpjegon se nuk e mbështet raportin e ekspertizës me të cilin OE e trajton si palë pa interes sipas nenin 4.1.26 të LPP, për shkak se OE ankues përmes pretendimeve ankimore fillimisht është munduar të mbrojë eliminimin e vetë duke aluduar se është i përgjegjshëm dhe se AK nuk ka respektuar dispozitat ligjore me rastin e eliminimit të tij nga ky aktivitet i prokurimit, me këtë veprim dhe aludim të OE e bënë që të jetë palë me interes.

Lidhur me pretendimin ankimor që ka të bëjë rreth eliminimit të OE ankues nga ana e AK me arsyetimin se listën e përshkrimit të çmimeve nuk e ka plotësuar sipas kërkesave të AK, fillimisht duke ofruar sikur totali i përgjithshëm pa TVSH dhe totalin me TVSH si dhe tek TVSH nuk ka vendosur çmime po tekst, PSH konstaton se AK ka bërë veprim të drejtë dhe konform dispozitave ligjore për prokurim publik që janë në fuqi, konkretisht nenit 44.3 të RRPP Nr. 001/2022, i cili citon: "Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes „header" apo kudo tjetër në dokumentet standarde.". Përshkrimi i çmimit është pjesë e Dosjes së Tenderit dhe jo procesverbali i hapjes. Andaj, kërkesë e AK tek përshkrimi i çmimeve ka qenë që të vendoset çmimi pa TVSH dhe çmimi me TVSH, gjë të cilën OE ankues nuk e ka bërë konform kërkesës përveç kësaj në vend të TVSH ka vendosur tekst, veprim i cili është i sanksionuar me dispozitën ligjore Rrjedhimisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të RRPP

Nr.001/2023, nenet 40, 40.7, 44 si dhe nenin 40.6, pika a dhe b, OE ankues për këtë aktivitet të prokurimit është administrativisht i pa përgjegjshëm. "Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit".

Nëse i referohemi konsistencës së vendimeve të OSHP të nxjerra nga bordi aktual, e pikërisht raportit të ekspertizës me nr. 2023/0158 dhe vendimin e PSH nr. 2023/0158 të dt. 30.05.2023, për të cilin ju është referuar pala ankimore dhe për aktivitetin i cili është përcjellë disa herë me ankesa në AK dhe në OSHP dhe disa herë është kthyer në ri-vlerësim, atëherë PSH sqaron se në këtë vendim (paraprak) është mbështetur arsyetimi i ekspertit shqyrtues i cili ka të bëjë me çështjen e njëjtë, dhe palë ka qenë vetë OE që tani është ankues dhe i cili ka bërë lëshimin e njëjtë. Eksperti shqyrtues këtë lëshim të OE e ka evidentuar dhe paraqitur në raportin e ekspertizës nr.2023/0158, por ka rekomanduar që të merret si devijim i vogël konform nenit 59.4 të LPP., me çrast PSH e ka mbështetur këtë arsyetim të këtij pretendimi me vendim të PSH nr. 2023/0158 të dt. 30.05.2023, ngase ndryshe nga eksperti shqyrtues i cili ka për qëllim të shqyrtoj vetëm pretendimet ankimore, PSH ka për obligim që kujdeset edhe për parimet ligjore, interesin e përgjithshëm, qëllimin, ekonomicitetin dhe barabarësinë e palëve në një procedurë.

Kështu që, nëse PSH në një aktivitet të prokurimit ka lejuar që një lëshim ligjor i OE ofertues, të merret si një devijim i vogël konform nenit 59 të LPP, atë e ka bërë duke i marrë parasysh shumë rrethana te krijuara brenda një aktiviteti te prokurimit dhe me natyrën e aktivitetit të prokurimit, por kjo nuk do të thotë se i jep të drejtë OSHP që ato lëshime ti bëjë vazhdimisht të ligjshme e aq më pak nuk i jep te drejtë asnjë pale që atë lëshim ta përsërit dhe të thirret në konsistencë të një vendimi të OSHP.

Kjo ankesë u përfshi në pikën 4 të dispozitivit për shkak se OE ka menduar se ky vendim duhet të jetë në konsistencë edhe me vendimin tjetër paraprak të OSHP.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrë në ketë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese.

Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik OE "Astraplan SH.P.K."

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit

shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij si dhe mbështet rekomandimin e ekspertit që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik OE "Pro & Co Group sh.p.k"

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në ketë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhenë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit

shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekpertizës së tij si dhe mbështet rekomandimin e ekspertit që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, 62 dhe 72 të LPP, të cituara në Ankesë dhe në raporte të ekspertizave. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë Juridike:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë në afat prej 30 ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK-Policia e Kosovës
- OE ankues
- Arkivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb-faqe zyrtare;